



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen së vet të datës 05.04.2018 nxorri këto vendime:

### **VENDIMET 1-2018**

#### **Vendimi 1.1**

##### **Aplikimet për sponsorizim**

**1.1.1** - Bordi i FAK nxjerr vendim që propozimi për sponsorizim i përgaditur nga kryetari i FAK Shkëlqim Krasniqi t'u dërgohet të gjithë kompanive që janë në listën e kompanive të përzgjedhura si kompani me potencial për sponsorizim.

#### **Vendimi 1.2**

##### **Organizimi i kuvendit të rregullt të FAK**

**1.2.1** - Duke u bazuar në strategjinë zhvillimore të FAK dhe nevojën që FAK të bëjë plotësimin dhe amandamentimin e statutit të organizatës, bordi i FAK aprovoi listen me propozim amandamentet e statutit. Kjo listë me amandamentet e propozuara duhet t'i dërgohet të gjithë pjesëmarrësve në kuvend jo më vonë se 2 javë para datës së mbajtjes të kuvendit të FAK.

Me qëllim të nxjerrjes në votim të këtyre plotësimeve dhe amandamenteve si dhe ndryshimeve të tjera eventuale të cilët mund të propozohen nga anëtarët e FAK, bordi nxjerr vendim që të organizoj një kuvend të rregullt pune të FAK me datën 30.04.2018.

#### **Vendimi 1.3**

##### **Kategorizimi i pilotëve paragllajdist sipas rregullores për 01/2018**

**3.3.1** - Bordi i FAK unanimisht aprovoi vlerësimin dhe kategorizimin e pilotëve paragllajdist me kategorizim IPPI të propozuar nga komisionet përkatëse të paragllajdistimit precision/distance dhe të bërë sipas rregullores:

RREGULLORJA 01/2018 - KATEGORIZIMI I PILOTËVE PARAGLLAJDIST SIPAS IPPI STATNARDIT TE FAI DHE KRITERET PËR DEKORIM DHE ARRITJE TË PILOTIT

Këto vlerësime do të publikohen në webfaqen zyrtare të FAK 2 javë pas nxjerrjes së këtij vendimi.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

### **Vendimi 1.4**

#### **Ndryshimi i kriterit për përcaktim të pilotëve paraglajdist precision/distancë për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare**

**1.4.1** - Bordi i FAK nxjerr vendim për ndryshim të kriterëve për financim të garuesve që garojnë në diciplinat e ndryshme të paraglajdizmit, ashtu që largohet obligimi për vetëpërcaktim të pilotit për diciplinën primare dhe sekondare të garave në paraglajdizëm (Precizion dhe distancë), me këtë rast shfuqizohet vendimi i datës 15.03.2017, (VENDIMET 2-2017, artikulli: Vendimi 2.4).

Me këtë vendim Federata sipas mundësive të saja financon garuesit për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare vetëm duke u bazuar në rankimin e FAI, pra në bazë të vendimit të datës 15.03.2017 (VENDIMET 2-2017, artikulli: Vendimi 2.3 Definimi i shkallës së përkrahjes së pilotëve sipas rezultateve në garat ndërkombëtare)

### **Vendimi 1.5**

#### **Shqyrtimi i kërkesës së aeroklubit “Balonat e Sahit Ukes” për anëtarësim në FAK**

**1.5.1** - Bordi shqyrtoi kërkesën për anëtarësim në FAK bashkë me dokumentacionin e dorëzuar nga aeroklubi “Ballonat e Sahit Ukës” dhe unanimisht aprovoi këtë kërkesë për anëtarësim.

Aeroklubi “Ballonat e Sahit Ukës” obligohet që deri më datën 31.05.2018 të kryej të gjitha obligimet financiare ndaj FAK ashtu që të mbajë statusin e klubit aktiv në FAK.

Prishtinë, 07.04.2018

---

Shkelqim Krasniqi  
Kryetar i bordit të FAK